



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
*Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*  
**KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: [klsh.org.al](mailto:klsh.org.al); web-site [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. 1432/\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .08.2019

**V E N D I M**

**Nr. 49, Datë 19.08.2019**

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË PUKË “MBI AUDITIMIN E  
REGULLSHMËRISË FINANCIARE<sup>1</sup>”**

**(Për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2018)**

Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Pukë, rezultuan devijime nga kadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale. Fusha kryesore të cilat janë konstatuar gabime në procedurat e prokurimeve me fondet buxhetore dhe zbatimit të kontratave të punimeve, të cilat ndikojnë në performancën e këtij institucioni.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes.

**VENDOSA:**

**I.** Të miratoj Opinionin e Auditimit dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit në Bashkinë Pukë sipas programit të auditimit nr. 1432/1, datë 29.12.2018, për periudhën 01.01.2017 - 31.12.2018.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

---

<sup>1</sup> Nga kontrolli i zbatimit të standardeve të auditimit nga Drejtori i Përgjithshëm, u konstatua se në auditimin financiar, nga subjekti Bashkia Pukë, nuk janë kryer të gjitha testet e nevojshme të auditimit sipas pikave të riskut dhe materialitetit, referuar sistemeve të kontrollit për vitin 2018, kjo për faktin se pasqyrat financiare deri në momentin e përfundimit të punës në terren nuk ishin mbyllur nga subjekti i audituar (trajtuar në faqet 26-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit), nuk plotësojnë kushtet për dhënien e një opinion për auditimin financiar të pasqyrave të vitit 2018, pavarësisht faktit që në Projektraportin e Auditimit është dhënë opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare të vitit 2017.

## Opiniononi i auditimit

### **Opinionin i kualifikuar me rezervë mbi pasqyrat financiare të vitit 2017** <sup>2</sup>

Ne kemi kryer auditimin e rregullshmërisë financiare mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 24.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit SSAI 1700, dhe ISSAI 1200, si dhe në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar tek pjesa, Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga Njësia e Qeverisjes Vendore Bashkia Pukë dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Pukë për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2017, ku përfshihet pasqyra e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (hyrjeve dhe daljeve të pagesave në para, pasqyra e amortizimit, pasqyrën e krahasimit të fondeve buxhetore dhe rezultateve aktuale, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra, kryerjen e inventarëve për në fund të vitit. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave, që nuk kanë ndikim të dukshëm mbi nivelin e materialitetit dhe në vendimmarrjen e përdorueseve të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në standardet ISSAI 1700<sup>3</sup>, dhe ISSAI 1200<sup>4</sup>, përveç efekteve të çështjes të përshkruar në seksionin e Bazës për Opinion të Kualifikuar për pasqyrat financiare të vitit 2017 pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Bashkinë Pukë në datën 31 dhjetor 2017 në llogaritë vjetore.

### **Opiniononi i auditimit:**

*Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në standartet ISSAI 1700, dhe ISSAI 1200, përveç efekteve të çështjes të përshkruar në seksionin e Bazës për Opinion të Kualifikuar për pasqyrat financiare të vitit 2017, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Bashkinë Pukë në datën 31 dhjetor*

<sup>2</sup> Një opinion i kualifikuar jepet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë ose kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

<sup>3</sup> Objektiv i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

<sup>4</sup> Objektiv i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi

2017.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë të detajuar në paragrafin “ Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga subjekti i audituar Njësia e VQV Bashkia Pukë, e theksuar nga ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

### **Baza për opinion të kualifikuar mbi pasqyrat financiare të vitit 2017**

*ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450 shprehet : “Objektivi i audituesit është të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit”*

Në planifikim ne kemi llogaritur vlerën e materialitetit duke marrë parasysh riskun e lartë të auditimit ndaj të cilit për të marrë një siguri të arsyeshme, audituesi duhet të tolerojë një normë më të ulët të gabimit material. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 është 1,769,425 lekë (0.5 % x 353,885,062 lekë). Çdo gabim apo shumë e gabimeve mbi këtë vlerë, e cila përbën gabim material, por jo të përhapur në llogaritë vjetore të vitit 2017 , në bazë të ISSAI 1705 përbën bazë për opinion të kualifikuar. Gabimet materiale për vitin 2017 paraqitet në zërat e Bilancit :

**-Llogaria 202 “Studime dhe Projektme”** është mbivlerësuar në vlerën **8,877,737 lekë**,

**- Llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”** është mbivlerësuar në vlerën **4.495,599 lekë**,

**- Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”** është nënvlerësuar në vlerën **3,500,000 lekë**

**- Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”** është nënvlerësuar në vlerën **4,623,583 lekë**,

të cilat janë individualisht dhe si shumë *mbi nivelin e materialitetit* të përcaktuar sipas kërkesave të Manualit të Auditimit financiar dhe modifikojnë opinionin e audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit .

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Pukë**

Nëpunësi Autorizues dhe nëpunësi zbatues të Bashkisë Pukë janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshime dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Staf i drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave në taksat e tarifave vendore.

### **Përgjegjësitë e Audituesve Shtetëror të KLSH-së mbi auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalie materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së gjithashtu aplikon gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme

lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun, ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

### **Opinion mbi përputhshmërinë e procedurave të prokurimit (i kualifikuar i kundërt)**

1. Nga auditimi mbi përputhshmërinë e procedurave të prokurimit publik, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti Bashkia Pukë, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), bazuar në ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, “Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë”, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Kualifikuar”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale.

### **Baza për opinion të kualifikuar mbi prokurimet publike:**

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se u konstatuan devijime nga kuadri rregullator përse i përket, zbatimin të procedurave të prokurimit, të cilat nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

- Në zbatimin e punimeve të kontratës për punë publike me objekt “Rruga auto Lumzi, Njësia Administrative Lumzi”, u konstatuan devijime materiale në zërat e matshëm, fakt që tregon se mbikëqyrja e punimeve të investimeve është një zonë me risk në menaxhimin e investimeve publike, duke evidentuar një dëm ekonomik në vlerën 4.34 milionë lekë.

- Janë realizuar 12 procedura prokurimi me vlerë më të lartë se 800,000 lekë, nga të cilat në vitin 2017, janë realizuar 8 procedura me vlerë totale të fondit limit 110,909,760 lekë dhe në vitin 2018, janë realizuar 4 procedura me vlerë totale të fondit limit 28,919,189 lekë. Nga ana e grupi të auditimit, është bërë auditimi total i këtyre procedurave.

-Për arsye të skualifikimit të operatorëve ekonomikë si pasojë e devijimeve të vogla të parashikuara në ligj, dhe OE të shpallur fitues edhe pse në kushtet e mosplotësimin të DST, janë përdorur fonde publike në kundërshtim me kërkesat ligjore të prokurimeve në vlerën 105,559 mijë lekë, nga 139,099 mijë lekë që është fondi limit i këtyre objekteve, e cila përbën 75.8 % të vlerës së kontratave të lidhura, si rezultat i kualifikimit dhe shpalljes fitues të OE apo BOE të cilët nuk kanë plotësuar kërkesat e DST, në të njëjtat kushte me OE e skualifikuar por me ofertë ekonomike më të lartë se ato të skualifikuar dhe konkretisht:

1. Në tenderin me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Sabah Sinani”, me fond limit 26,923,616 lekë pa TVSH
2. Në tenderin me objekt “Rruga auto Lumzi, Njësia Administrative Lumzi” Bashkia Pukë, zhvilluar në vitin 2017 me vlerë të fondit limit 34.594,481 lekë pa TVSH
3. Në tenderin me objekt “Rehabilitimi i shëtitores Gjegjan”, Bashkia Pukë, zhvilluar në vitin 2017 me vlerë të fondit limit 15,000,000 lekë pa TVSH
4. Në tenderin me objekt “Rehabilitim i Rrjetit Ujitës te Ujëmbledhësit Kukaj, Dega Luf” Pukë”, me fond limit 25,828,429 lekë pa TVSH
5. Në tenderin me objekt “Rikonstruksion rruga Plet, Lagjja Uragji”, Bashkia Pukë me fond limit 1,376,555 lekë pa TVSH
6. Në tenderin me objekt “Blerje ushqimore 2018”, Bashkia Pukë, me fond limit 1,836,354 lekë pa TVSH.

## **A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga Bashkia Pukë nuk janë implementuar plotësisht kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si më poshtë:

**Mjedisi i Kontrollit-** Nuk është realizuar harta e proceseve ku specifikohet qarkullimi i dokumentave dhe Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe Raporti vjetor për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin 2017 nuk janë hartuar sipas formatit standard të paraqitur në Manualin e Menxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave jashtë afateve ligjore.

**Aktivitetet e Kontrollit-** Nga ana e titullarit nuk është hartuar dhe miratuar evidence dokumentare për gjurmën e auditimit për procedurat që lidhen me veprimtaritë kryesore të Bashkisë Pukë. Nga ana e Nëpunësit Autorizues nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe dokumentimin e tij.

**Vlerësimi i Riskut-** Për minimizimin e riskut, mashtrimit dhe parregullsive, nga Nëpunësi Autorizues nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e këtyre fenomeneve.

**Informimi dhe komunikimi-** Realizohet sipas shkallës së strukturave, nëpërmjet takimeve javore raportimeve mujore, tremujore dhe vjetore ku sipas kërkesave u sigurojnë drejtuesve informacion të rregullt mbi arritjen e objektivave. Përveç kësaj mënyre, informimi realizohet edhe nëpërmjet publikimeve dhe njoftimeve të adresuara për publikun.

**Monitorimi-** Deklarata e vetëvlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm nuk është dorëzuar Brenda afateve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Këto veprime janë në kundërshti me ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, nenet 20, 21, 22 dhe 23.

Gjithashtu nga Bashkia Pukë nuk është organizuar shërbimi i auditimit të brendshëm në që përbën risk të shtuar në funksionimin e institucionit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditin e brendshëm publik” neni 10 “Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm”, dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik”, pika 1. (në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën I, faqe 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi.** Nga Bashkia Pukë të merren masa që të miratohet harta e proceseve ku specifikohet qarkullimi i dokumenteve, deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe Raporti vjetor për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të formulohen sipas formatit standard të paraqitur në Manualin e Menxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe të dërgohen brenda afateve ligjore në Ministrinë e Financave, si dhe të miratohet evidence dokumentare për gjurmën e auditimit për procedurat që lidhen me veprimtaritë kryesore të Bashkisë Pukë.

Gjithashtu nga ana e nëpunësit autorizues të analizohen dhe përditësohen kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe të raportohen masat e marra për parandalimin e riskut të mashtrimit dhe parregullsive.

**1.2. Rekomandimi.** Nga Bashkia Pukë të marren masa për organizimin shërbimit të auditimit të brendshëm sipas mënyrave që parashikohen në kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditin e brendshëm publik” neni 10 “Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm” dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik”, pika 1.

*Brenda muajit Shtator 2019*

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga *Llogaria 202 “Studime dhe Projektme”* e bilancit kontabël mbyllur më 31 dhjetor 2017 me vlerë 10,015,337 lekë, konstatohet se disa studime e projektme në vlerën 8,877,737 lekë, i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe të trashëguara nga 4 ish Komunat të cilat tashmë janë pjesë e Bashkisë Pukë dhe nuk janë klasifikuar si Aktive të Qëndrueshmë të Trupëzuara

Ky mos klasifikim në aktive të qëndrueshme të trupëzuara është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare“ dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b” (në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën II, faqe 19-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”** e bilancit kontabël mbyllur më 31 dhjetor 2017 është ngarkuar padrejtësisht në vlerën **273,484 lekë**. Kjo ka ardhur si pasojë e normës së gabuar të amortizimit të përdorur kundrejt llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” ndaj të cilës është aplikuar norma e amortizimit 13,8 % në vend të normës 5,8%.

Gjithashtu kjo llogari, 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”, është mbivlerësuar në vlerën **4.222.115 lekë** si pasojë e amortizimit të lloagrisë 215 “Mjete transporti”, mjete të cilat ishin amortizuar totalisht sipas verifikimeve në librat e kontabilitetit dhe vazhdonte amortizimi edhe pse VKN kishte shkuar në zero.

Këto veprime, dalë nga auditimi i Pasqyrave Financiare të vitit 2017 dhe mbështetur në bazën ligjore në fuqi deri në të njëjtin vit, janë në kundërshtim me VKM Nr.25, date 20.01.2001, “Per Miratimin e Planit Kontabel Publik te Organeve te Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetrorre Qendrore e Lokale si dhe njesive qe varen prej Tyre”, udhëzimin nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2006 për institucionet qëndrore , organet e pushtetit vendor dhe njesive që varen prej tyre si dhe të njesive të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, VKM Nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 pika nr.40 (në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën II, faqe 38-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Nga ana e Sektorit të Financës të Bashkisë Pukë të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet në debi të llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 6,765,917 lekë, në debit të llogarisë 212 “Ndërtime dhe konstruksione” në vlerën 2,111,820 lekë me kundërparti 202 “Studime dhe kërkime” për vlerën totale 8,877,737 lekë.

**2.2. Rekomandimi:** Nga ana e Sektorit të Financës të Bashkisë Pukë të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarinë 219 “Amortizim i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara” duke e debituar për vlerën 4.222.115 lekë dhe 273,484 lekë.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Sipas aktit noterial Nr. 3990 Repertori, Nr. 809/1 Koleksioni, datë 20.10.2015, është përpiluar kontratë e dhurimit të aksioneve të Futboll Klub Tërbunit, ku dhuruesi G. F. dhuron 65% të kapitalit tek pranuesi i dhurimit Bashkia Pukë. Sipas kësaj kontrate Bashkia Pukë, ka 100 aksione, pjesëmarrja në lekë për 2,000,000 lekë ose 100%.

Në datën 20.10.2015, është vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë “Futboll Klub Tërbuni” sha mbi miratimin e shtimit të kapitalit të Futboll Klub Tërbunit sha me vlerën 1,500,000 lekë duke u bërë vlera e kapitalit në shumën 3,500,000 lekë. Kjo shtesë e kapitalit është bërë duke rivlerësuar aksionet, por nuk ka një arsyetim ligjor për rritjen e vlerës së tyre, një rritje vlere që ndikon në rritjen e kapitalit të “Futboll Klub Tërbuni”.

Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Pukë në “Futboll Klub Tërbuni” sh.a në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet financiare të Bilancit kontabël 2016 dhe 2017 në kundërshtim ligjin me 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare “ dhe urdhrin e ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 “Investime në Pjesëmarrje” (në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën II, faqe 38-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Nga ana e Sektorit të Financës të Bashkisë Pukë të merren masa për të bërë regjistrimin në kontabilitet të investimit 100% në pjesëmarrje të Bashkisë Pukë në kapitalin aksionar të “Futboll Klub Tërbuni” me vlerë kontabël 3,500,000 lekë në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” të Bilancit Kontabël, si dhe të arsyetohet dhe argumentohet pse është ndërmarrë një rivlerësim i aksioneve në momentin e përthithjes së tyre nga Bashkia Pukë.

*Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi** Shpenzimet për vendime gjyqësore në kontabilitet paraqiten në vlerën 6,296,724 lekë në vitin 2017, si pjesë e detyrimeve të prapambetura në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, ndërsa sipas listës së vendimeve gjyqësore të formës së prerë të vitit 2017 shuma paraqitet në vlerën 11,420,786 lekë. Kjo shumë nuk paraqet vlerën e saktë në fund të vitit 2017 sepse janë futur dhe vendime gjyqësore të vitit 2018 në vlerën 500,479 lekë. Vlera gjendje përfundimtare e vendimeve gjyqësore në fund të vitit 2017 është 10,920,307 lekë. Diferenca ndërmjet gjendjes kontabël dhe listës së vendimeve gjyqësore vjen si pasojë e vendimit gjyqësor nr.169 dt 26.11.2013 i “Shoqata e të verbërve Puke” në vlerën 4,623,583 lekë i paregjistruar në kontabilitet duke nënvlersuar llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në kundërshtim me ligjin 9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 71 pika g, VKM nr.783, kapitulli II, Rregulla të përgjithshme për pasqyrat financiare vjetore pika 2.2 Rregullat për marrjen në llogari të elementëve të pasqyrave financiare vjetore si dhe në kundërshtim me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 “Kudri i Përgjithshëm për përgatitjen e Pasqyrave Financiare – i përmirsuar” pikat 22 – 26 (në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën II faqe 38-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Nga ana e Sektorit të Financës të Bashkisë Pukë të merren masa për të bërë regjistrimin në kontabilitet të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 169 dt 26.11.2013 i “Shoqata e të verbërve Puke” në vlerën 4,623,583 lekë në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”

*Menjëherë*

**5. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me inventarizimin e pasurisë publike janë konstatuar mangësitë si më poshtë:

Rregjistrat kontabël në të cilët janë detajuar aktivet (210 “Toka, troje e terrene”, 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete e vepra ujore”, 214 “Instaime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”, 215 “Mjete transporti”) nuk përmbushin kriteret minimale të paraqitjes së formatit si dhe nuk janë azhurnuar pas bashkimit të njesive administrative duke dhënë një pamje jo të plotë për këto rregjistra. Për aktivet e tjera afatgjata materiale dhe jo materiale nuk është hartuar rregjistër kontabël. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin 10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 8 dhe Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat 26,dhe 30.

Janë konstatuar parregullsi në ngritjen e urdhrave dhe moskosistencë në grupe inventarizimi si më poshtë;

Urdhëri nr.248 datë 22.09.2017 emëron në komisionin e vlerësimit dhe inventarizimit në Njësinë Administrative Qelëz përkatësisht, z.F. M., Z.N. A., zj.E. Gj. dhe z.M. P., ndërsa në proces – verbalin për vlerësimin dhe inventarizimin marin pjesë z.T. K., z.F. M. dhe zj.S. M... F. M. dhe S. M. janë persona që kanë firmosur edhe në proces-verbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit për të njëjtat aktive që edhe i kanë vlerësuar. Këto veprime janë kundërshtim me ligjin 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 7 dhe pikën 97 dhe 105 të udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

- Në komisionin e vlerësimit dhe inventarizimit i cili sipas udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duhet të përbëhet nga jo më pak se 3 veta dhe kryetar i komisionit duhet të jetë Nëpunësi Zbatues i njësisë, në urdhërin nr.249 datë 22.09.2017 kryetar komisioni është caktuar, z.A. K. i cili nuk mban funksionin e Nëpunësit Zbatues të njësisë. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin 10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 8 dhe Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 99.

Në asnjë nga procedurat e vlerësimit dhe inventarizimit të aktiveve nuk është përpiluar lista e aktiveve të identifikuar për vlerësim nga nëpunësi.zbatues.

Urdhëri nr.259 datë 29.09.2017 i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e grupit të punës për asgjësimin e inventarëve të evidentuar nga komisioni i verifikimit të cilat janë jashtë përdorimit, ka emëruar në komisionet e nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjësimit 5 anëtarë përfshirë dhe përgjegjësit material, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr.10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 8 dhe Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 100.

*(në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën II, faqe 38-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Pukë të merren masa për të azhurnuar regjistrat kontabël me informacion të plotë pas bashkimit me njësitë administrative, duke plotësuar kërkesat minimale të formatit të paraqitjes së tyre, të përpilohet lista e aktiveve të identifikuar për vlerësim dhe inventarizim nga nëpunësi zbatues. Procesverbalet përpara se të miratohen nga Titullari të bëhet rakordimi nëse janë në përputhje të plotë me urdhrat e ngritur prej tij, si dhe komisionet për nxjerrjen jashtë përdorimit të jenë kategorikisht të ndryshëm nga komisionet e vlerësimit dhe inventarizimit.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e paraqitura rezulton se më datën 31.12.2018 Bashkia Pukë ka detyrime të papaguara ndaj të tretëve në vlerën **43,682,262 lekë**, të cilat janë pasqyruar në kontabilitet, në llogarinë nr.401-408, furnitor e llogari të lidhura me to, prej tyre 33 subjekte kreditore në vlerën 32,149,473 lekë dhe 12 persona të cilët kanë fituar vendimet e gjykatave në vite të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën **11,532,789 lekë**. Veprimet apo mos veprimet janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne R.SH”,ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016), Neni 40 <sup>(5)</sup>-E drejta për të kryer shpenzime,

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”ndryshuar me udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014.

-Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”,

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”, *(në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën II, faqe 27-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1.Rekomandimi:** Bashkia Pukë, Sektori i Financës, bazuar në Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”dhe Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe pikat 116-117- *Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore*”, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën **43,682,262 lekë**, sipas Aneksit bashkangjitur mbi gjendjen e faturave të palikujduara me datën 31.12.2018, e rakorduar kjo me pasqyrën e dërguar në Ministrinë e financave.

#### *Në mbledhjen me të afërt të Këshillit Bashkiak*

**7. Gjetje nga auditimi: a.** Në Bashkinë Pukë, në fund të vitit 2018 rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 73 subjekte të biznesit të vogël, 16 subjekte të biznesit të madh, për të cilat llogaritet mungesë të ardhurash **në vlerën 10,014,243 lekë**. **b.** Mbi vjeljen e detyrime për tatim taksat lokale, konstatohet se nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me vjeljen e taksës së

<sup>5)</sup> Ndryshuar me ligjin nr. 57/2016.



ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-Drejtoria Rajonale Shkodër, në vlerën **153,273 lekë**. Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Pukë, konstatohet se deri më 31.12.2018, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë 5 persona për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 932,6 m<sup>2</sup>. Përsa më sipër, nuk janë zbatuar kërkesat e nenit 23 të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar dhe VKB nr. 3, datë 09.01.2017 “Për miratimin e taksave e tarifave vendore për vitin 2017”.

Po ashtu Zyra e Tatim Taksave Bashkia Pukë për arkëtimin e debitorëve të taksave vendore dhe taksës ndikimit në infrastrukturë, nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, veprim jo në përputhje me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, nenet 40, 41 90, 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 dhe nenin 12, të UMF nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve” (në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën IV faqe 102-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandimi:** Zyra e Tatim Taksave në Bashkinë Pukë, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve tatimore duke bërë njoftim vlerësimit tatimore:

-për 73 subjekte të biznesit të vogël, 16 subjekt të biznesit të madh, debitorë **në shumën 10,014,243 lekë** dhe

-për 5 persona në vlerën totale të pa arkëtuar prej **153,273 lekë, e ardhur e munguar** nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore të legalizuara.

Duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

**a-** Tu dërgohen bankave (subjekteve që nuk u është dërguar) urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

**b-** Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

**c-** Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 %, kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

**d-** Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative, të bëhet kallëzim penal.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8.Gjetje nga auditimi:** Bashkia Pukë, administron pasuri, sipas listave të VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive” dhe VKM -ve të tjera për transferimin e pronave në ish Komunitat aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Pukë për të cilat:

**a-**Nuk ka vepruar për marrjen në dorëzim të aseteve të qëndrueshme me komision dhe me procesverbal të nënshkruar nga përfituesi Bashkia Pukë dhe nga institucionet qendrore si dorëzues të aseteve, veprimi jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 35/a.

**b-**Nuk ka kryer kolaudimin dhe vlerësimin e aseteve, nuk ka kryer inventarizimin kontabël dhe fizik të aseteve, nuk ka aplikuar në ZRPP Pukë për regjistrimin e aseteve, ku sipas të dhënave që na u paraqitën, aktualisht janë regjistruar në pronësi të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore,

gjithsej 6685,3 ha pyje dhe kullota, nga të cilat 6600 ha të regjistruara nga ish Komuna Qerret dhe 85,3 ha kullota të regjistruara nga Bashkia Pukë dhe nuk është vazhduar për më tej ky veprim, mosveprime këto, të cilat janë jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pikat 20, 21 dhe 22, në ligjin nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, në VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” në VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive.”pika 66.

c-Nuk është hartuar përmbledhja dhe bashkimi i listave të asetëve të saj dhe të katër Njësive Administrative ish-komunat, Gjegjan, Rrape, Qelëz dhe Qerret, për të përpiluar në këtë mënyrë një pasqyrë të qartë të pasurive të paluajtshme të bashkisë, me qëllim inventarizimin, vlerësimin, administrimin, regjistrimin, kontabilizimin dhe dokumentimin në pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Pukë, veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1 (në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën VI faqe 125-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandim:** Bashkia Pukë të marrë masa për asetet që ka në administrim si dhe për asetet e trashëguara nga ish Komunat në juridiksion të saj, e sidomos për pyjet e kullotat, nëpërmjet strukturave të saj, Drejtorisë së Urbanistikës, Planifikimit të Territorit dhe Zyrës Juridike, të kryejë inventarizimin, vlerësimin, kontabilizimin, pasqyrimin në aktivet e qëndrueshme të pasqyrave financiare dhe të marrë masa për regjistrimin e të gjitha asetëve në ZVRPP Pukë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**9.Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Pukë për periudhën e auditimit janë realizuar pesë kontrata për punë publike me vlerë totale 115,096 mijë lekë. Nga verifikimi i dosjes teknike të zbatimit për objektin “Rruga Lumzi, Njësia administrative Rrape, fshati Lumzi, Bashkia Pukë” me vlerë 40,204 mijë lekë, rezultoi se mungonte libri i masave, i cili është dokumenti bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve sipas kontratës dhe situacioneve. Në dosjen teknike nuk gjendet asnjë dokument i hartuar nga administrata e bashkisë për këtë mangësi (në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën III faqe 69-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandim:** Titullari i AK të marrë masa që për kontratat e punëve publike, nisur nga pesha që zënë në shpenzimet e bashkisë dhe domosdoshmëria e cilësisë së punimeve, e cila ndikon në shfrytëzimin e objekteve në të ardhmen, të caktojë një komision/punonjës teknik për monitorimin e kontratave, i cili të pasqyrojë gjendjen faktike të realizimit të kontratës dhe grafikut të punimeve, para certifikimit të punimeve të realizuara.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga Bashkia Pukë për periudhën 01.01.2017-31.12.2018, janë vendosur 74 gjoba me vlerë të përgjithshme në shumën prej 103,000 lekë. Janë arkëtuar 39 gjoba me vlerë 40,500 lekë dhe nuk janë marrë masa për arkëtimin e 35 gjobave të tjera të vendosura nga policia bashkiake për shkelje administrative, duke mos ndjekur rrugën ligjore për kthimin e tyre në titull ekzekutiv, veprim në mospërputhje me kërkesat e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” nenet 20, 30, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë, në vlerën 62,500 lekë (Më hollësisht trajtuar në pikën IV faqe 118-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1 Rekomandim:** Bashkia Pukë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore, për arkëtimin e gjobave të pa arkëtuara në vlerën 62,500 lekë, sipas Aneksit Nr. 10 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

*Menjëherë*

**11.Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Pukë, nuk është miratuar në strukturë dhe për rrjedhojë nuk është krijuar struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e kundërligjshme” të ndryshuar, neni 3, ligjit nr. 107/2014, datë 29.04.2009 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, neni 29 si dhe ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 dhe neni 10 pika 14 (*Më hollësisht trajtuar në pikën V faqe 118-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1Rekomandim:** Nga Bashkia Pukë të merren masa, për ndryshimin e strukturës organizative të institucionit, në të cilën të përfshihet struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, me qëllim monitorimin e territorit të bashkisë.

*Menjëherë*

## **B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i Njesisë Publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore) dhe ndjekur në të gjitha shkallët e gjyqimit, kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **10,020,738 lekë. Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, si më poshtë:*

1. **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “**Rruga Lumzi, Njësia administrative Rrape, fshati Lumzi, Bashkia Pukë**, me vlerë të kontratës 40,204,193 lekë me TVSH, me kontraktor Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “D. I.” shpk & “Gj.” shpk SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **4,337,390 pa TVSH**, në zërat e punës “Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m<sup>3</sup> në kanale me gjerësi > 2 m”, “Struktura monolite betoni C20/25 (për ballnat)”, “FV hekur i zakonshëm D>12 mm” dhe “Mbushje me çakull (brenda shpatullave të mureve)”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 111/20 prot datë 02.05.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pukë dhe BOE “D. I.” shpk & “Gj.” shpk SHPK (*në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën III faqe 69-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Pukë të merren masa, duke ndjekur të gjithë procedurat administrative dhe ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **4,337,390 pa TVSH** nga BOE “D. I.” shpk & “Gj.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 111/20 prot datë 02.05.2017 me objekt “**Rruga Lumzi, Njësia administrative Rrape, fshati Lumzi, Bashkia Pukë**, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera dhe vonesave në përfundimin e punimeve.

*Menjëherë*

**2.Gjetje nga auditimi:** -Nga auditimi i kryer për planifikimin, realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, konstatohet se:

a. -nga, Sektori i Pyjeve e Kullotave dhe Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk kanë kryer plotësisht monitorimin për të arkëtuar detyrimin sipas kontratave të qirasë, për kontratat e lidhur midis Bashkisë Pukë dhe shoqërive private, për dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore e kullosore, veprimi jo në përputhje me kërkesat e VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, kapitulli VI, pikat 1,2,9 e 10, sipas aneksit nr.1 në vlerën **5,209,864 lekë**.

**b.** -nga Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk është llogaritur saktë taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, nuk është kryer përlllogaritja në bazë të çmimit referencë që është kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, për Lejen e Ndërtimit nr.17, datë 04.12.2018, në shkelje të ligjit nr. nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar neni 46,Udhëzimi i KM nr.4, datë 30.9.2015 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2015”, Udhëzimi KM nr.3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016” dhe VKB nr.63, datë 19.12.2016 dhe nr.68, datë 30.12.2017 “Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2017 të Bashkisë Pukë”, në vlerën **55,436 lekë** (në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën IV faqe 102-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandim:** Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, Sektori i Pyjeve e Kullotave, Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **5,265,300 lekë**, përkatësisht :

-vlera **5,209,864 lekë**, detyrim sipas kontratave për dhënie me qira të sipërfaqeve pyjore e kullimore, sipas aneksit nr.1 bashkangjitur RPA-së.

-vlera **55,436 lekë**, detyrim taksë ndikimi në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, për Lejen e Ndërtimit nr.17, datë 04.12.2018.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit janë konstatuar 7 urdhër -shpenzime të vitit 2017 dhe 2018 për shërbime televizive që Bashkia Pukë ka marrë nga televizioni lokal TV Puka, urdhëri i ngritur për komisionin e marrjen në dorëzim të të cilave përbëhet nga 2 anëtarë, përkatësisht zj.D. I. dhe z. B. A. për vitin 2017 dhe zj. Dh. M. dhe z.B. A. për vitin 2018.Ky veprim është bërë në kundërshtim me udhëzimin 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 43 .

Gjithashtu rezultoi se me urdhër-shpenzimet nr.714 datë 27.12.2018 dhe nr.732 datë 27.12.2018 është paguar për Shpenzime Transporti për 12 bileta avioni me intinerar Tiranë – Firenze – Tiranë, me vlerë totale **365,536 lekë**, pa pasur një marrëveshje të nënshkruar binjakëzimi nga këshillat përkatës të secilës prej njërive të vetqeverisjes vendore, veprim ky në kundërshtim me ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 14 si dhe në shkelje të Udhëzimit nr.22 datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e VKM nr.870 datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

Me urdhër-shpenzimet nr.65 datë 28.02.2017 dhe nr.112 datë 30.03.2017 “Shpenzime telefonike” në emër të përfituesit T. A. Sh.A, është bërë pagesa ndaj përfituesit të shërbimit telefonik me NIPT K.....M “B. H. SHPK” në vlerën totale **52,512 lekë**, Këto shpenzime telefonike janë bërë në emër të subjektit privat “ B. H. SHPK ku është aksioner Kryetari i Bashkisë z.Gj. Gj., por jo në emër të vet kryetarit të Bashkisë siç e kërkon VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër celulari të personave juridikë, publikë”, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për paisjen me numër celulari të personave juridikë, publikë”, pikat 1, 9 si dhe ligjit nr.9936, date 26.6.2008 “Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”(në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën II, faqe 38-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Bashkia Pukë të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **418,048 lekë** nga përfituesit si më poshtë;

Urdhër – Shpenzimi				
Nr.	Datë	Vlerë	Personat Përfitues	Vlera e përfituar për t'u shlyer
714	27.12.2018	66,376 lekë	Gj. K.	33,368 lekë
			L. H.	33,368 lekë
732	27.12.2018	298,800 lekë	V. Sh.	29,880 lekë
			Gj. Gj.	29,880 lekë
			Gj. D.	29,880 lekë
			M. P.	29,880 lekë
			A.M.	29,880 lekë
			B.A.	29,880 lekë
			Dh.M.R.	29,880 lekë
			E.Gj.	29,880 lekë
			F.P.	29,880 lekë
			A.D.	29,880 lekë
65	28.02.2017	50,027 lekë	B.H.	50,027 lekë
112	30.03.2017	2,485 lekë	B.H.	2,485 lekë
<b>Totali</b>				<b>418,048 lekë</b>

Nga ana e titullarit të merren masa në ngritjen e grupeve të marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve në përmbushje të pikës 43 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

*Menjëherë*

**B2. SHPENZIME TË REALIZUARA NË KUNDËRSHTIM ME KËRKESAT LIGJORE TË PROKURIMIT DHE EFEKTE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.**

1. Për shkak të mos zbatimit të kërkesave ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, duke kualifikuar operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, janë përdorur fonde publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, **në vlerën 105,559,435 lekë**, e cila përbën 1/2 e numrit të tenderave të zhvilluar, ose 75.5% e vlerës së kontratave të lidhura dhe vlera 773,927 lekë në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik të zhvilluara, u konstatuan se 5 procedura prokurimi janë kryer në kundërshtim me nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” pikën 5 të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Operatorët ekonomikë janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të hartuara nga Njësia e Prokurimit e të miratuara nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, duke mos garantuar përmbushjen me cilësi të kontratës në këto tendera, për shkak të mos përmbushjes së kritereve të vendosura në DST. Shkeljet e konstatuara në tendera në mënyrë të detajuar janë si më poshtë vijon:

**1/1 Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Sabah Sinani”, me fond limit 26,923,616 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2017, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “Sh.” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 22,967,096 lekë, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson

kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, në vlerën 26,923,616 lekë.**

**1/2. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt " Rruga auto Lumzi, Njësia Administrative Lumzi" Bashkia Pukë, zhvilluar në vitin 2017 me vlerë të fondit limit 34.594,481 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "D. I." shpk & "Gj." SHPK, me vlerë të ofertës 33,503,495 lekë, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, në vlerën 34,594,481 lekë.**

**1/3. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt "Rehabilitimi i shëtitores Gjegjan", Bashkia Pukë, zhvilluar në vitin 2017 me vlerë të fondit limit 15,000,000 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "Sh." SHPK, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, në vlerën 15,000,000 lekë.**

**1/4. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt "Rehabilitim i Rrjetit Ujitës te Ujëmbledhësit Kukaj, Dega Luf" Pukë", me fond limit 25,828,429 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2017, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "J." SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 25,333,350 lekë, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST. Tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, në vlerën 25,828,429 lekë**

**1/5. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt "Rikonstruksion rruga Plet, Lagjja Uragji", Bashkia Pukë me fond limit 1,376,555 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2017, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "D. I." SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 1,349,975 lekë, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST. Tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, në vlerën 1,376,555 lekë**

**1/6. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt "Blerje ushqimore 2018", Bashkia Pukë, me fond limit 1,836,354 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2018, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "N." SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 1,782,780 lekë, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, në vlerën 1,836,354 lekë** (në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën III faqe 69-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandim:** Bashkia Pukë të analizojë arsyet e kualifikimit të pa drejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST dhe kualifikohen, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, pasi këta OE nuk japin garanci për kryerjen me cilësi të kontratës.

*Menjherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rruga Lumzi, Njësia administrative Rrape, fshati Lumzi, Bashkia Pukë, me vlerë të kontratës 40,204,193 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë "D. I." SHPK & "Gj." shpk SHPK, u konstatua që për zërin "Gërmim shkëmbi i copëtuar me eskavator 0.5 m<sup>3</sup>, shkëmb, me themele me gjerësi > 2 m, me shkarkim në mjet" është vendosur çmimi 398 lekë/m<sup>3</sup>, sipas analizës 3.122/b të manualit të çmimeve të vitit 2015. Nisur nga fakti që në preventivin e ofertës ekziston zëri i punës "Gërmim shkëmbi i copëtuar me eskavator 0.5 m<sup>3</sup>, shkëmb, me themele me gjerësi ÷ 2 m, me shkarkim në mjet", çmimi i të cilit në preventiv është 300 lekë/m<sup>3</sup>, ndërsa në manual është sa 0.882 i çmimit të zërit të ri, grupi i negocimit, edhe pse ka përdorur çmimet e manualit, duhet të kishte bërë konvertimin e çmimit të këtij zëri pune me 0.882 të zërit të ofertuar, ose 265 lekë/m<sup>3</sup>. Përsa më sipër, nisur nga sasia e situacionuar e këtij zëri pune të ri prej 5819 m<sup>3</sup>, do të situacionohej me **773,927 lekë pa tvsh më pak**, vlerë që përbën përdorim pa

ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Pukë. Ky veprim është në mospërputhje me kreun II, pika 8.3 të UKM Nr .2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe ngarkon me përgjegjësi Mbikëqyrësin e punimeve dhe projektuesin e objektit, si anëtar të grupit negociator të çmimeve të reja (në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën III faqe 69-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandim:** Nga grupet e punës të ngritura nga Autoriteti Kontraktor për negocimin e çmimeve të reja, të paofertuara në fazën e tenderimit, të merren masa që çmimet e miratuara të jenë të argumentuara teknikisht, duke ju referuar manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi, por të jenë çmimet më të mira.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## C. MASA ADMINISTRATIVE:

### **C.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt-konstatimet nr. 7, 8 dhe 9, datë 31.01.2019 (Bashkia Pukë), vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit, mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe nenet 15 shkronja (c, ç) dhe 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative në raport me shkeljet e konstatuara, për **3 (tre) punonjës**, si më poshtë:

### **Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave:**

- 1. z. A. Z.** me detyrë ish Zv/Kryetar i Bashkisë Pukë, në cilësinë e Kryetarit të KVO.
- 2. z. A. K.**, me detyrë ish Sekretar i Këshillit Bashkiak, në cilësinë e anëtarit të KVO.
- 3. z. E. S.**, me detyrë Drejtor i Urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të KVO, **në 4 (katër) procedura prokurimi:**
  - a-**Në procedurën e prokurimit me objekt “Rruga auto Lumzi, Njësia Administrative Lumzi” Bashkia Pukë, me fond limit 34,594,481 lekë pa TVSH.
  - b-**Në procedurën e prokurimit me objekt “Rehabilitimi i shëtitores Gjegan”, Bashkia Pukë, me fond limit 15,000,000 lekë pa TVSH.
  - c-**Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstrukcion i shkollës së mesme “Sabah Sinani”, me fond limit 26,923,616 lekë pa TVSH.
  - ç-**Në procedurën e prokurimit me objekt “Rehabilitim i Rrjetit Ujitës te Ujëmbledhësit Kukaj, Dega Luf” Pukë”, me fond limit 25,828,429 lekë pa TVSH.

### **Për shkeljet e mëposhtme:**

Në procedurat e mësipërme, duke pasur parasysh se KVO-ja ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE/BOE e tjerë, për të cilët çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël, është konsideruar mos përmbushje e kërkesave në DST, gjerësisht se vendimet e marra nga KVO për shpalljen fitues të operatorëve ekonomikë edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), janë në kundërshtim me nenin 2-“Parimet e përzgjedhjes”, nenin 24- “Anulimi i një procedure prokurimi”, nenin 53- “Shqyrtimi i ofertave”, nenin 55- “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, si dhe neni 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në pikën III, faqet 69-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

## **C.2. Për Inspektoriatin e Mbrojtjes Territorit (IMTV) Bashkia Pukë.**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë, Kryetarit të Bashkisë Pukë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë për një mbikëqyrës dhe një kolaudator punimesh**, si më poshtë:

1. **50,000 lekë për OE “I.D.” shpk**, me përfaqësues z. I.D. në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin *Rruga Lumzi, Njësia administrative Rrape, fshati Lumzi*, Bashkia Pukë, me sipërmarrës punimesh BOE “D. I.” SHPK & “Gj.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 4,337,390 lekë pa tvsh si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.
2. **500,000 lekë për OE “D.” SHPK**, me përfaqësues Z. V. T., në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin *Rruga Lumzi, Njësia administrative Rrape, fshati Lumzi*, Bashkia Pukë, me sipërmarrës punimesh BOE “D. I.” SHPK & “Gj.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 4,337,390 lekë pa tvsh si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

## **C.3 Për Nëpunësin e Parë Autorizues**

Referuar shkeljes së cituar në gjetjen numër 6 të masave organizative për mosparaqitje të vlerës **4,623,583 lekë** në vitin 2017 si detyrim i prapambetur dhe mosparaqitjen e dokumentacionit justifikues të shpenzimit për pagesë në strukturën përgjegjëse të thesarit brenda 30 ditëve nga data e dokumentit justifikues, KLSH i rekomandon Nëpunësit të Parë Autorizues marrjen e masave në përputhje me kërkesat e nenit 52 “Kryerja e shpenzimeve” dhe nenit 71 “Kundërvajtjet administrative” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në fuqi, ndaj Nëpunësit Zbatues të Bashkinë Pukë, **zj. F. P.**, duke analizuar gjetjen e mësipërme, të reflektuara më hollësisht në pikën IV, faqe 102-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

## **D. MASA DISIPLINORE:**

### **D.1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, geramat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Pukë që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2018, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për **8 (tetë) punonjës**, si më poshtë:

**a. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 germa (c), për 4 punonjësit si më poshtë:**

**1.Znj.F. P.** me detyrë Drejtore e Financës, Buxhetit dhe Ndihmës Ekonomike.

### **Për shkeljet e mëposhtme:**

-Për moslikuidim të detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve në vlerën **43,682,262 lekë**, të cilat janë pasqyruar në kontabilitet, në llogarinë nr.401-408, furnitor e llogari të lidhura me to, prej



tyre 33 subjekte kreditore në vlerën 32,149,473 lekë dhe 12 persona të cilët kanë fituar vendimet e gjykatave në vite të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 11,532,789 lekë. Veprimet apo mos veprimet janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016), Neni 40 <sup>(6)</sup>-E drejta për të kryer shpenzime,

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014.

-Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”,

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

**2.Z.H. D.**, me detyrë, Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave vendore.

**3.Znj.E. Ç.**, me detyrë, specialiste Sektorit të Taksave dhe Tarifave vendore.

### **Për shkeljet e mëposhtme:**

-Për performancë jo të mirë të nivelit të arkëtimeve nga Sektori Taksave e Tarifave Vendore, ku në auditimin e programimit të të ardhurave nga aplikimi i taksave dhe tarifave vendore rezultoi se, programimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, për vitin 2017, është miratuar në vlerën 37,500 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 20,812 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 16,688 mijë lekë, ose 55%, për vitin 2018, programimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, është miratuar në vlerën 44,000 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 25,510 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 18,490 mijë lekë, ose 58%. Detyrimet debitore të taksave për bizneset gjendje me 31.12.2017 janë në vlerën 9,202 mijë lekë nga 87 subjekte, me 31.12.2018 janë në vlerën 10,014 mijë lekë nga 89 subjekte. Realizimi i të ardhurave është në nivele shumë të ulët për të dy vitet 2017-2018.

-Për mos zbatim të plotë të monitorimit të kontratave të qirasë, për dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore e kullosore, veprimi jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, kapitulli VI, pikat 1,2,9 e 10, sipas aneksit nr.1 me pasojë, *dëm ekonomik në Buxhetin e Bashkisë në vlerën 5,209,864 lekë.*

-Për mos marrje masa të veçanta lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- për 5 persona për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 932,6 m<sup>2</sup> sipas aneksit nr.2 me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 153,273 lekë., jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, neni 35, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar dhe VKB nr.63, datë 19.12.2016 dhe nr.68, datë 30.12.2017 “Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2017 të Bashkisë Pukë”.

**4.Z.E. S.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit në Bashkinë Pukë, për periudhën vitet 2017, 2018.

### **Për shkeljet e mëposhtme:**

-Për mos marrje masa të veçanta lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- për 5 persona për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 932,6 m<sup>2</sup> sipas aneksit nr.2 me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 153,273 lekë., jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”

<sup>6)</sup> Ndryshuar me ligjin nr. 57/2016.

të ndryshuar, neni 35, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar dhe VKB nr.63, datë 19.12.2016 dhe nr.68, datë 30.12.2017 “Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2017 të Bashkisë Pukë”.

-Për mos administrim të mirë të pasurive, sipas listave të VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive” dhe VKM-ve të tjera për transferimin e pronave në ish Komunitet aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Pukë për të cilat:

**a-**Nuk ka vepruar për marrjen në dorëzim të aseteve të qëndrueshme me komision dhe me procesverbal të nënshkruar nga përfituesi Bashkia Pukë dhe nga institucionet qendrore si dorëzues të aseteve, veprimi jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 500, datë 14.8.2001 dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 35/a.

**b-**Nuk ka kryer kolaudimin dhe vlerësimin e aseteve, nuk ka kryer inventarizimin kontabël dhe fizik të aseteve, nuk ka aplikuar në ZRPP Pukë për regjistrimin e aseteve, ku sipas të dhënave që na u paraqitën, aktualisht janë regjistruar në pronësi të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, gjithsej 6685,3 ha pyje dhe kullota, nga të cilat 6600 ha të regjistruara nga ish Komuna Qerret dhe 85,3 ha kullota të regjistruara nga Bashkia Pukë dhe nuk është vazhduar për më tej ky veprim, mosveprime këto, të cilat janë jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pikat 20, 21 dhe 22, në ligjin nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, në VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” në VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive.”pika 66.

**c-**Nuk është hartuar përmbledhja dhe bashkimi i listave të aseteve të saj dhe të katër Njësi Administrative ish-komunitet, Gjegjan, Rrape, Qelëz dhe Qerret, për të përpiluar në këtë mënyrë një pasqyrë të qartë të pasurive të paluajtshme të bashkisë, me qëllim inventarizimin, vlerësimin, administrimin, regjistrimin, kontabilizimin dhe dokumentimin në pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Pukë, veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 510, datë 10.06.2015 Kreu III, pika 1.

-Për mos llogaritje të saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, nuk është kryer përlllogaritja në bazë të çmimit referencë që është kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, për Lejen e Ndërtimit nr.17, datë 04.12.2018 të qytetarit Ramazan Sulejmani, në shkelje të ligjit nr. nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar neni 46, Udhëzimi i KM nr.4, datë 30.9.2015 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2015”, Udhëzimi KM nr.3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016” dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.63, datë 19.12.2016 dhe nr.68, datë 30.12.2017 “Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2017 të Bashkisë Pukë”, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë në vlerën **55,436 lekë**.

**5. Z.Gj. F.** me detyrë, Përgjegjës i sektorit të Strukturës Përgjegjëse për Pyjet e Kullotat.

#### **Për shkeljet e mëposhtme:**

-Për mos zbatim të plotë të monitorimit të kontratave të qirasë, për dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore e kullosore, veprimi jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, kapitulli VI, pikat 1,2,9 e 10, sipas aneksit nr.1 me pasojë, dëm ekonomik në Buxhetin e Bashkisë në vlerën **5,209,864 lekë**.

-Për mos administrim të mirë të pasurive, sipas listave të VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive” dhe VKM-ve të tjera për transferimin e pronave në ish Komunitat aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Pukë për të cilat:

**a-Nuk** ka vepruar për marrjen në dorëzim të aseteve të qëndrueshme me komision dhe me procesverbal të nënshkruar nga përfituesi Bashkia Pukë dhe nga institucionet qendrore si dorëzues të aseteve, veprimi jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 35/a.

**b-Nuk** ka kryer kolaudimin dhe vlerësimin e aseteve, nuk ka kryer inventarizimin kontabël dhe fizik të aseteve, nuk ka aplikuar në ZRPP Pukë për regjistrimin e aseteve, ku sipas të dhënave që na u paraqitën, aktualisht janë regjistruar në pronësi të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, gjithsej 6685,3 ha pyje dhe kullota, nga të cilat 6600 ha të regjistruara nga ish Komuna Qerret dhe 85,3 ha kullota të regjistruara nga Bashkia Pukë dhe nuk është vazhduar për më tej ky veprim, mosveprime këto, të cilat janë jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pikat 20, 21 dhe 22, në ligjin nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, në VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” në VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive.”pika 66.

**c-Nuk** është hartuar përmbledhja dhe bashkimi i listave të aseteve të saj dhe të katër Njësi Administrative ish-komunitat, Gjegjan, Rrape, Qelëz dhe Qerret, për të përpiluar në këtë mënyrë një pasqyrë të qartë të pasurive të paluajtshme të bashkisë, me qëllim inventarizimin, vlerësimin, administrimin, regjistrimin, kontabilizimin dhe dokumentimin në pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Pukë, veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 510, datë 10.06.2015 Kreu III, pika 1.

**6. K. M., me detyrë zv.kryetar i Bashkisë, në cilësinë e kryetarit të KVO,**

**7.E. Gj., me detyrë specialiste finance, në cilësinë e anëtarit të KVO**

**8. M. P., me detyrë specialiste juriste**

#### **Për shkeljet e mëposhtme:**

Në tenderin me objekt “Blerje ushqimore 2018”, Bashkia Pukë, me fond limit 1,836,354 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2018, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “N.”SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 1,782,780 lekë, i cili nuk plotëson kriteret e vëndosura në DST. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, në vlerën 1,836,354 lekë** (në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën III faqe 69-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Shënim:**

Për punonjësit e mëposhtëm nuk mund të rekomandojmë masë, pasi mangësitë e konstatuara dhe të evidentuara në Raportin përfundimtar të Auditimit janë të papërfillshme.

**1.Z.Gj. Sh.** me detyrë specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore Njësia Administrative Gjegjan, periudha vitet 2017-2018.

**2.Znj.Gj. M.** me detyrë, specialiste e Taksave dhe Tarifave Vendore Njësia Administrative Qerret periudha 23.03.2018 deri 31.12.2018.

**3.Znj.S. M.** me detyrë, specialiste e Taksave dhe Tarifave Vendore Njësia Administrative Qelëz periudha 24.10.2017 deri 31.12.2018.

**4. Znj. F. B.,** me detyrë ish shefe e financës gjatë hartimit të bilancit të vitit 2015 dhe me detyrë aktuale specialiste finance.

**5. Z. Gj. D.,** me detyrë përgjegjës i Policisë Bashkiake.

### **Për punonjësit e larguar.**

Për 3 (tre) ish punonjësit e mëposhtëm, nuk rekomandojmë masa disiplinore, pasi shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personi nuk është në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara do të ishte kërkuar masë disiplinore “Vërejtje”, përkatësisht:

**1. Znj. A. Gj.** me detyrë, ish specialiste e Taksave dhe Tarifave Vendore Njësia Administrative Qerret periudha 01.01.2017 deri 20.02.2018, larguar nga puna.

**2. Znj. E. M.** ish jurist në Sektorin Juridik, larguar nga puna.

**3. Z. L. B.,** ish specialist i Urbanistikës.

### **E. INDICIE PENALE:**

Bashkia Pukë, nga kualifikimi dhe shpallja fitues e OE apo BOE të cilët nuk kanë plotësuar të gjitha kriteret për kualifikim, ka shkaktuar përdorim të fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet për vlerën prej **94,364,456 lekë pa TVSH**, procedura për të cilat referuar shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe aktet e tjera bashkëlidhur, **dërgohen për vlerësim dhe veprime të mëtejshme procedurale, për tu studiuar si Indice Penale nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë**, referuar nenit 248 dhe 281, të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, **për 4 procedurat, si vijon:**

**1-Procedurën e prokurimit me objekt:** “*Rruga auto Lumzi, Njësia Administrative Lumzi*”, për vlerën prej 34,594,481 lekë pa TVSH, me BOE të shpallur fitues “**D. I.**” dhe “**Gj.**” Shpk, për vlerën prej **33,503,494** lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 1,090,986 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 9 OE/BOE, janë skualifikuar për mungesë dokumentacioni 7 OE dhe kualifikuar 2 OE nga ku është shpallur fituese OE i cili nuk plotëson të gjitha kriteret për kualifikim **dhe konkretisht:**

- OE “D. I.” shpk ka paraqitur për eksperiencë të ngjashme një objekt të ndërtuar në Lezhë, për të cilin nuk ka paguar taksat vendore;

- Bilanci i vitit 2015 i pakonfirmuar nga administrata tatimore;

- Mungon vërtetimi për xhiron vjetore të vitit 2013;

- Numri mesatar i punonjësve për vitin 2015 dhe 2016 është 39.7 dhe jo 42.7 punonjës, pjesa takuese sipas DST (95% sipas marrëveshjes x 45 punonjës);

- Nuk ka inxhinier mjedisi të përfshirë në listëpagesat e vitit 2016;

- Mungon eksperiencia e ngjashme. është paraqitur objekti “Ndërtim rrugë e ura në Vig”, që ka përfunduar më shumë se tri vjet para hapjes së tenderit; Shuma e të gjithë objekteve të tjera të paraqitura, të cilat janë realizuar brenda tri viteve të fundit është 37,290,000 lekë dhe jo 69,190,000 lekë, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26, pika 6/b;

- OE “Gj.” shpk, nuk ka Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar për të tre bilancet e paraqitura;

- Bilanci i vitit 2015 i pakonfirmuar nga administrata tatimore;

- Mungon eksperiencia e ngjashme e OE “Gj.” SHPK. Është paraqitur objekti “Rikonstruksion i rrugës Brucaj”, Komuna Pult, Qarku Shkodër, me vlerë 1,878,708 lekë me tvsh, ndërkohë që në zbatim të marrëveshjes së përbashkët, i kërkohet eksperiencë e ngjashme në vlerë 2,075,669 lekë me tvsh.

- Mungojnë shtojca e konfliktit të interesit dhe gjendjes gjyqësore të OE “Gj.” shpk.

- Mungon dokumentacioni i teknikut të ndërtimit

Nisur nga sa më sipër, BOE “D. I.”shpk & “Gj.”shpk duhet të ishte skualifikuar.

Në këto kushte, vendimi i KVO për ta shpallur fitues këtë OE nuk është i drejtë dhe ky OE duhet të ishte s’kualifikuar dhe Titullari i AK duhet të kishte anuluar këtë procedurë për të rishpallur një procedurë të re prokurimi.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE, i cili nuk i plotëson kriteret e DST, ka sjellë për pasojë shkelje të barazisë në tendera duke shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën e kontraktuar prej 33,503,495 lekë.

**2-Në procedurën e prokurimit me objekt** *“Rehabilitimi i shëtitores Gjogjan”*, Bashkia Pukë, me fond limit 15,000,000 lekë pa TVSH, me OE të shpallur fitues *“Sh.” Shpk*, për vlerën prej 12,460,515 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 2,539,515 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 6 OE/BOE, janë skualifikuar për mungesë dokumentacioni 3 OE dhe kualifikuar 3 OE nga ku është shpallur fituese OE i cili nuk plotëson plotësisht të gjitha kriteret për kualifikim **dhe konkretisht:**

Autoboti i paraqitur, me targa SR .... B, është në pronësi të J. C. dhe nuk ka asnjë kontratë qeramarrje. Ky mjet nuk është Autobot, por kamion i pajisur me bot. Kjo është një nga arsyet e skualifikimit të OE *“N.” shpk*

- Kontratat e qerasë:

1. Nr. 757 Rep, Nr. 311 kol, datë 08.05.2012 me shoqërinë Rr. shpk, për rulin, e bërë për 10 vjet;

2. Nr. 795 Rep, Nr. 323 kol, datë 14.05.2012 me B. M., për kamionin Mercedes me targa FR .... B, e bërë për 10 vjet;

3. Nr. 585 Rep, Nr. 331 kol, datë 06.04.2016 me shoqërinë T&T shpk, për autobetonierat dhe pompen e betonit, e bërë për 10 vjet, nuk janë paraqitur në bilanc. Ky fakt është trajtuar edhe për shoqërinë *“N.” shpk* dhe ka qenë një nga arsyet e skualifikimit.

- Subjekti ka paraqitur punime të ngjashme të kryera në Portin Detar Vlorë, por ska paraqitur asnjë dokument që vërteton që ka shlyer taksat vendore në këtë Bashki. Ky fakt është trajtuar nga KVO edhe për OE *“S.” shpk* dhe ka qenë një nga arsyet e skualifikimit.

- Bilanci i vitit 2015 rezulton të jetë i pakonfirmuar në çdo fletë nga organet tatimore që sjell dyshime për vërtetësinë e këtij bilanci. Ky fakt është trajtuar nga KVO edhe për OE *“S.” shpk* dhe ka qenë një nga arsyet e skualifikimit.

Në këto kushte, vendimi i KVO për ta shpallur fitues këtë OE nuk është i drejtë dhe ky OE duhej të ishte s’kualifikuar dhe Titullari i AK duhet të kishte anuluar këtë procedurë për të rishpallur një procedurë të re prokurimi.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE, i cili nuk i plotëson kriteret e DST, ka sjellë për pasojë shkelje të barazisë në tendera duke shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën e kontraktuar prej 12,460,515 lekë.

**3-Procedurën e prokurimit me objekt:** *“Rikonstruksion i shkollës së mesme “Sabah Sinani”*, për vlerën prej 26,923,616 lekë pa TVSH, me OE të shpallur fitues *“Sh.” Shpk*, për vlerën prej **22,967,096** lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 3,956,520 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 9 OE, janë skualifikuar për mungesë dokumentacioni 4 OE dhe kualifikuar 5 OE nga ku është shpallur fituese OE i cili nuk plotëson plotësisht të gjitha kriteret për kualifikim **dhe konkretisht:**

OE *“Sh.”* ka një mesatare punonjësish të deklaruar për periudhën e kërkuar janar 2016 – prill 2017, që është 95 punëtorë. Në datën 19.06.2017 kjo OE ka marrë pjesë dhe ka fituar në një tender tjetër të zhvilluar nga Bashkia Pukë me objekt *“Rehabilitim i Qendrës së Fshatit Gjogjan”*, ku numri i punëtorëve të kërkuar në DST për këtë objekt është mesatarisht 50 për periudhën nga janari 2016 deri në muajin mars 2017. Duke qenë se për procedurën e prokurimit të shkollës *“Sabah Sinani”* janë kërkuar 60 punonjës, atëherë ky OE nuk e plotëson kriterin për numrin e punonjësve.

Gjithashtu, deklaratat e drejtuesit të OE *“Sh.”* për të 2 procedurat ku është shpallur fitues janë të njëjta përsa i përket makinerive dhe stafit drejtues që do të ndjekin punimet në të dyja veprat, gjë që nuk jep garanci për kryerjen në afat dhe me sukses të punimeve të marra përsipër nga kjo OE. Si punim të ngjashëm ka paraqitur rikonstruksionin e një shkolle në Bashkinë Tepelenë (ku ka qenë pjesë e një BOE) por nuk ka paraqitur asnjë dokument që vërteton se ka shlyer detyrimet në këtë bashki.

Në këto kushte, vendimi i KVO për ta shpallur fitues këtë OE nuk është i drejtë dhe ky OE duhej të ishte s'kualifikuar dhe KVO dhe Titullari i AK duhet të kishte shpallur fitues ofertën e paraqitur nga Operatori Ekonomik "A. K." shpk.

Shpallja fitues e OE i cili nuk i plotëson kriteret e DST dhe mos shpallja fitues e ofertës të OE "A. K." shpk, ka sjellë për pasojë shkelje të barazisë në tendera duke shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën e kontraktuar prej 22,967,096 lekë.

**4-Procedurën e prokurimit me objekt:** *"Rehabilitim i Rrjetit Ujitës te Ujëmbledhësit Kukaj, Dega Luf" Pukë*, për vlerën prej 25,828,429 lekë pa TVSH, me OE të shpallur fitues **"J."** Shpk, për vlerën prej **25,333,350** lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 495,079 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 12 OE/BOE, janë skualifikuar për mungesë dokumentacioni 11 OE/BOE nga ku është shpallur fituese OE i cili nuk plotëson plotësisht të gjitha kriteret për kualifikim dhe konkretisht:

- Eskavatori i paraqitur nuk konfirmohet të jetë sipas kërkesave të DST, pasi nuk thuhet që është me goma. Ky kriter është një nga arsyet e skualifikimit të BOE "D.-1"shpk & "A.M."shpk dhe "N." shpk.

- B.B. është paraqitur me kontratë jonoteriale dhe me dëftesë pjekurie e jo me diplomë sipas DST. Ky rast është trajtuar për shoqërinë "Sh." (tekniku F. H.) dhe për shoqërinë "N." shpk (tekniku R. I.) dhe në gjykimin e KVO-së, ka qenë një arsye për t'u skualifikuar.

Në këto kushte, vendimi i KVO për ta shpallur fitues këtë OE nuk është i drejtë dhe ky OE duhej të ishte s'kualifikuar dhe Titullari i AK duhet të kishte anuluar këtë procedurë për të rishpallur një procedurë të re prokurimi.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE, i cili nuk i plotëson kriteret e DST, ka sjellë për pasojë shkelje të barazisë në tendera duke shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën e kontraktuar prej 25,333,350 lekë.

#### **Për shkeljet e mëposhtme:**

Në procedurat e mësipërme, duke pasur parasysh se KVO-ja ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE/BOE e tjerë, për të cilët çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël, është konsideruar mos përmbushje e kërkesave në DST, gjykojmë se vendimet e marra nga KVO për shpalljen fitues të operatorëve ekonomikë edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), duke mos anuluar këto procedura, kanë sjellë impakt negativ në buxhet, trajtim diskriminues dhe të pabarabartë të ofertuesve dhe mos zbatim të dispozitave të ligjit, duke shpallur fitues me kriteret të paplota, janë në kundërshtim me nenin 2-*"Parimet e përzgjedhjes"*, nenin 24- *"Anulimi i një procedure prokurimi"*, nenin 53-*"Shqyrtimi i ofertave"*, nenin 55- *"Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese"*, si dhe neni 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në pikën III, faqet 69-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Shënim i Kryetarit të KLSH:***Mbështetur në opinionin e kualifikuar të kundërt për prokurimet publike gjithë praktika e auditimit përcillet në Prokurori si indicie penale. Indicia Penale do përcillet direkt nga Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.*

*Me shkresën nr. 1432/10, datë 19.08.2019, dërgohen praktikat e mësipërme të prokurimit për veprime të mëtejshme procedurale për t'u studiuar si Indicie Penale nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë.*

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.*

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**